

VENDIM
Nr.980, datë 2.7.2008

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, AKADEMISË SË EDUKIMIT FIZIK
DHE SPORTEVE “VOJO KUSHI”, TË MJEDISEVE TË ISH-MENSËS SË
STUDENTËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 901 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim, pa shpërblim, Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”, të mjediseve të ish-mensës së studentëve (kati përdhes i ndërtesës së konviktit, që ndodhet brenda territorit të kësaj akademie), pronë publike, në administrim të Ndërmarrjes nr.2 të Trajtimit të Studentëve, sh.a., për ngritjen e Bibliotekës Kombëtare të Sportit.

2. Autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për të lidhur aktmarrëveshjen (kontratën) përkatëse me Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha